

## **Hapet thirrja për aplikime për studentët në L'École des Mines d'Alès, në Francë, në kuadër të Programit Erasmus +, për semestrin e dytë të vitit akademik 2022-2023.**

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit të Tiranës në L'École des Mines d'Alès, në Francë për semestrin e dytë për vitin akademik 2022-2023.

<https://www.imt-mines-ales.fr/>

### **Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e studentëve për studime;

### **Nivelet e mobilitetit për studentët:**

- Master;
- Ph.D;

### **Kohëzgjatja e bursave:**

- 1 semestër;

### **Fushat e studimit:**

- Master i Shkencave në Inxhinieri Matematike dhe Informatike;
- Ph.D.: Shkenca Natyrore, nënëfusha: Matematikë e Aplikuar;

Për më shumë informacion klikoni linkun:

<https://www.imt-mines-ales.fr/en/international/mobilities>

### **Bursat përfshijnë:**

- Kompensimin mujor (800 EUR në muaj për studentët);
- Kostot e udhëtimit (275 EUR);

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

### **Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Master:**

- CV (në gjuhën angleze / frëngje);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze ose frëngje);
- Diplomë e nivelit Bachelor;
- Listë notash e nivelit Bachelor (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze ose frëngje);

- Listë notash e nivelit Master (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze ose frëngje);
- Letër Motivimi në gjuhën angleze / frëngje;
- Certifikatë e gjuhës së huaj (anglisht / frengjisht);
- \*Learning Agreement;

*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvilloni në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm sektionin e parë ‘Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

**KUJDES:** Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin pritës lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti ‘‘Learning Agreement’’ tek sezioni ‘‘Commitment’’ firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

[https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Learning\\_agreement\\_for\\_studies\\_Erasmus\\_outgoing-2-1.docx](https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Learning_agreement_for_studies_Erasmus_outgoing-2-1.docx)

#### **Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Doktoraturë:**

- CV (në gjuhën angleze / frëngje);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze ose frëngje);
- Diplomë e nivelit Bachelor dhe Master;
- Listë notash e nivelit Bachelor (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze ose frëngje);
- Listë notash e nivelit Master (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze ose frëngje);
- Letër Motivimi në gjuhën angleze / frëngje;
- Certifikatë e gjuhës së huaj (anglisht / frengjisht);
- \*Learning Agreement;

*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvilloni në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm sektionin e parë ‘Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që*

*do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin pritës lëndë të njëjtë me ato që do të kryenit në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.*

*Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +.*

*Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:*

[https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Learning\\_agreement\\_for\\_studies\\_Erasmus\\_outgoing-2-1.docx](https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Learning_agreement_for_studies_Erasmus_outgoing-2-1.docx)

**Afati për aplikim: 4 Nëntor 2022 (për studentët Master) dhe 18 Nëntor (për studentët Ph.D)**

Universiteti pritës do të zhvillojë gjithashtu një intervistë online, përmes platformës Zoom.

Dokumentacioni duhet dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe të skanuara të dërgohen në adresën [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Sektorin për Marrëdhëni me Jashtë në adresën: [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al)

Universiteti i Tiranës ju uron Suksese në aplikim!